



### VENDIM

Nr.22 Datë 11.02.2015

### PËR

## FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 3 pika 35, 8 pika 1 gërma “a” 9 dhe 13 pika 1 gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, gërma “g”; neni 8, 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjessbëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.02.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “**GREEN ENERGY TRADING ALBANIA**” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjessbëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm

- Neni 9, pika 1  
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 2  
Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 3  
Dokumentacioni finaciar dhe fiskal është i plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, gërma a e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, gërma b e plotësuar.
- Neni 9, pika 4/10, gërma c e plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë **“GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” sh.p.k.**, për licencimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**